



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK

IShP – Departamenti i Epidemiologjisë dhe
Kontrollit të Sëmundjeve Infektive

GRIPË NË SHQIPËRI PËR SEZONIN 2018-2019 JAVA 46 (12-18 NËNTOR)

Buletini i Gripit nr.1

26 Nëntor 2018

PËRMBLEDHJE

Në këtë vëllim:

Përmbledhje	1
Prirja e IRS dhe IRP	3
Frekuenca e hasjes	3
Nr total i mostrave	4
Viruset e tjerë	5
Shpërndarja moshore	6
STRRA	7
STRRA moshore	8
IRA-pragu	11
Kurba epidemike	12
Info nga TESSY	13

Informacion kyç:

- Situata ne EURO-TESSY
- Përbërja e vaksinës
- STRRA

Përmbledhje

Nga të dhënat e raportimit sipas survejancës së infeksioneve akute respiratore të sipërme dhe të poshtme të sistemit ALERT, survejancës sentinel të sëmundjeve të ngjashme me Gripin (ILI) në rrethin e Tiranës, dhe survejancës së infeksioneve respiratore akute të rënda (SRRA) në spitalet kryesore në të gjithë vendin si dhe raportimit rutinë, vërejmë se trendi i infeksioneve respiratore paraqitet i qëndrueshem në javën 46/2018.

Kontinenti European

Në javën 46/2018 në kontinentin European aktiviteti i gripit në Evropë është ende i ulët. 24 vende nuk raportuan aktivitet të gripit, 21 vende raportuan përhapje sporadike, 1 vend përhapje lokale.

Ne këte javë 26 (3.2%) e mostrave të

marra nga survejnca sentinel janë konfirmuar me virusin e gripit nga të cilat 88.5% me virusin e tipit A dhe 11.5% me virusin e tipit B. **Nga nentipizimi i viruseve te tipit A, rezultojnë nentipet A(H1N1)pdm09 (77.3%) dhe A(H3N2) (22.7%).**

Nga survejanca jo-sentinel kanë rezultuar 271 mostra positive për virusin e gripit nga të cilat 93% janë të tipit A dhe 7% janë të tipit B. **Mbas nentipizimit 74.2% rezultuan A(H1N1)pdm09 dhe 28.5% A(H3N2).** Për viruset B nuk është raportuar gjenotipizim.

Të dhënat nga 23 vende që raportojnë në projektin EuroMOMO treguan se vdekshmëria nga të gjitha shkaqet ishte në nivele të ulëta dhe të pritshme për këtë kohë të vitit.

Rekomandimet e OBSH-së mbi përbërjen e vaksinës së gripit për Hemisferin Verior gjatë sezonit 2018 - 2019 janë:


A/Singapore/INFIMH-16-0019/2016 (H3N2)-like virus;
 B/Colorado/06/2017-like virus (B/Victoria/2/87 lineage);
 A/Michigan/45/2015 (H1N1)pdm09-like virus;

dhe për vaksinë quadrivalente:

B/Phuket/3073/2013-like virus (B/Yamagata/16/88 lineage)


Në bazë të analizimeve të thelluara filogjenetike të viruseve të dërguara nga Qendra Kombetare e Gripit në ISHP në qendrën e referencës në Londër (Francis-Crick Institute), është vlerësuar se një shtam virusi A(H1N1)pdm09, i izoluar në qendrën tonë mund të jetë një virus kandidat për vaksinën e gripit të sezonit të ardhshëm të hemisferit verior.

1. PËRQINDJA E MOSTRAVE RESPIRATORE QË KANË REZULTUAR POZITIVE PËR VIRUSET E GRIPIT, SIPAS KONTINENTETEVE




2. PRIRJA E INFEKSIONEVE RESPIRATORE TË SIPËRME (IRS) DHE TË POSHTËME (IRP) NË JAVËT 30 – 46 TË VITIT 2017 DHE TË VITIT 2018.

NUMRI I RASTEVE.




Në javën e 46 të vitit 2018 vërehet një trend i qëndrueshëm i numrit të infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme dhe ky numër është 7% më i lartë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

3. FREKUENCA E HASJES SË “INFEKSIONEVE RESPIRATORE TË SIPËRME DHE TË POSHTËME” SIPAS RRETHEVE NË JAVËN 30 DHE 46 TË VITIT 2018. INCIDENCA (RASTE/10.000)



Vërehet rënie e numrit të rasteve të IRA në disa rrethe të vendit

4. NUMRI TOTAL I MOSTRAVE TË ARDHURA SIPAS JAVËVE DHE REZULTATI LABORATORIK



Prej javes 40 (1 - 7 Tetor 2018) deri ne javen 47 (19 - 25 Nentor) jane grumbulluar 65 kampione nga qendrat e survejances ILI dhe SARI.

Para pranimit në laborator kryhet rregullisht monitorimi i cilësisë së mostrës sipas protokolleve standarte. Të gjitha mostrat e ardhura janë testuar me metodën molekulare të Real-Time RT PCR.


Nga analizimet e tyre nuk eshte identifikuar asnje rast positive per virusin e gripit.


5. REZULTATI I TESTIMIT PER VIRUSE TË TJERË RESPIRATORË

Sipas algoritmit të testimit, rastet negative për grip analizohen për viruse të tjera respiratore me anë të metodës molekulare. Si më poshtë paraqitet shpërndarja e rezultateve për javën 45 deri 47

Më poshtë vëmë re se një pjesë e totalit të kampioneve të analizuar 11 (29.7%) kanë rezultuar pozitive për viruse të ndryshëm respiratore:


Viruset të tjera respiratore	Java 45	% Pozitive	Java 46	% Pozitive	Java 47	% Pozitive
Rhinovirus -	1	7				
Coronavirus 43-	3	20	2	18		
Virusi respirator sincicial-	1	7			2	18
Parainfluenza tip 3-	1	7				
Parainfluenza tip 4			1	9		
Bocavirus	-	-	-	-	1	9
Negative	10		8		8	
Total	15	33%	11	27%	11	27%



6. SHPËRNDARJA E NUMRIT TOTAL TË RASTEVE SIPAS GRUP-MOSHËS

Vërehet që 18 (28%) e totalit të mostrave të marra i përkasin grupmoshës pediatrike 0-14 vjeç


7. SËMUNDJE E TEPËR E RËNDË RESPIRATORE AKUTE (STRRA)





Rasti klasifikohet si SRRRA (Sëmundje e rëndë respiratore akute) sipas përkufizimit të OBSH dhe si STRRA (Sëmundje tepër e rëndë respiratore akute) sipas klasifikimit tonë për të gjitha rastet që kanë nevojë për shtrim në repartet e terapisë intensive dhe kanë nevojë për oksigjenim.


11 (35) prej 65 pacientëve spitalorë kanë paraqitur komplikacione (STRRA)


8. SHPËRNDARJA E RASTEVE SRRRA DHE STRRA SIPAS JAVËVE



9. SHPËRNDARJA E RASTEVE STRRA SIPAS VENDIT TË MARRJES SË MOSTRËS**10. SHPËRNDARJA RASTEVE STRRA SIPAS GRUPMOSHËS DHE REZULTATI LABORATORIK**


11. NUMRI TOTAL I MOSTRAVE SIPAS VENDIT TË MARRJES DHE REZULTATIT LABORATORIK



12. NUMRI TOTAL I MOSTRAVE SIPAS VENDIT TË MARRJES DHE REZULTATIT LABORATORIK

Numri më i madh i mostrave ka ardhur nga Qendra Shendetesore Nr. 2, ndjekur nga SUSM.


13. KRAHASIMI I AKTIVITETIT TË “INFEKSIONEVE RESPIRATORE TË SIPËRME (IRS) DHE TË POSHTËME (IRP)” SIPAS SEZONEVE (JAVËT 40 – 20) DHE PRAGU EPIDEMIK. RASTE/100 000



Në javën 46/2018 aktiviteti i IRA paraqet:

- prirje e qëndrueshme
- aktivitet gjeografik të përhapur
- intensitet të ulët
- impakt të ulët



14. KURBA EPIDEMIKE DHE INFEKSIONET RESPIRATORE SIPAS JAVËVE (IRA RASTE/100 000)



Vërehet që trendi i mostrave të marra ndjek trendin e Infeksioneve respiratore (IRA)



1. INTENSITETI DHE PËRHAPJA GJEOGRAFIKE E GRIPIT DHE VIRUSET QË QARKULLOJNË NË RAJONIN EUROPIAN NË JAVËN 46. <http://flunewseurope.org/>



**Departamenti i Epidemiologjisë dhe
Kontrollit të Sëmundjeve Infektive
INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK**

Adresa:
Rr. "A. Moisiu" Nr. 80
Tiranë

Tel: + 355 42 374 756
Fax: + 355 42 370 058
www.ishp.gov.al
